

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i përgjithshëm - Divizioni civil, në trupin gjykues të përbërë nga Gjykatësi **Drilon HARAÇIA** - Kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve porotë Xhavit Elezi dhe Ismet Këndusi – anëtar të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Nëntor Oseku, në çështjen juridiko-civile të paditësit Sh. H. nga fshati P., Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson M. H., avokat nga Gjakova me autorizim në lëndë, kundër të paditurës B. (H.) H., e lindur B. nga fshati R., Komuna e Pejës, të cilën e përfaqëson I. I., avokat nga Peja me autorizim në lëndë, baza juridike; zgjidhje e martesës, në seancën kryesore jo publike, të mbajtur me dt.26.07.2016 në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe të paditurës dhe të autorizuarit të saj, me datën 17.08.2016 mori këtë;

A K T G J Y K I M

I. ZGJIDHET martesë me shkurorëzim në mes të paditësit Sh. (T.) H. nga fshati P., Komuna e Gjakovës, kundër të paditurës B. (H.) H., e lindur B. nga fshati R., Komuna e Pejës, e lidhur në Zyrën e Gjendjes Civile në fshatin Rr., Komuna e Gjakovës, me datën 04.03.2015, me numër rendor 6, me numër të referencës 2/2015RM/2012, të lëshuar me datën 13.04.2016, nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë, në kuptim të nenit 69 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Familjen i Kosovës.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi nëpërmjet të autorizuarit të tij ka parashtruar padi pranë kësaj Gjykate duke cekur se me të paditurën kanë lidhur martesë pranë ofiqarit të Zyrës së gjendjes Civile në fshatin Rr., Komuna e Gjakovës me dt.04.03.2015, me numër rendor 6, me numër të referencës 2/2015RM/2012, të lëshuar me datën 13.04.2016, nga kjo martesë ish bashkëshortët nuk kanë pasur fëmijë. Duke theksuar se martesë në mes të paditësit dhe të paditurës është bërë me datën 04.03.2015 Ashtu që në fakt ekziston vetëm aspekti formal i lidhjes së kurorës, ndërsa aspekti faktik nuk ka ekzistuar nga fakti se këtë e kanë biseduar që pas rregullimit të tërë dokumentacionit përkatës të vjen deri te martesë faktike, sipas adeteve të vendit. Mirëpo në ndërkohë për shkak të bindjeve kontradiktore në mes të bashkëshortëve kishte ardhë gjerë të mos pajtueshmëria për martesë. Në ndërkohë paditësi ka ardhë në dijeni lidhur me të paditurën që siç e cekem më lartë nuk ishin në lidhje faktike duke bashkëjetuar dhe as njëherë me parë në këtë aspekt nuk kishin kurrfarë lidhje tjetër, ashtu që ka kërkuar që për mos pajtueshmëri të mirësjellje të shpëputin këtë lidhje martesore në aspektin e marrëveshjes së përbashkët. Mirëpo edhe pas insistimit të paditësit e paditura nuk pranon një fakt të tillë duke e anashkaluar vullnetin e paditësit.

I autorizuari i të paditurës në përgjigje në padi të dhënë me dt. 13.06.2016, e ka kundërshtuar padinë e paditësit në tërësi, duke cekur se me argumente të vërteta, të kapshme dhe reale hedhen poshtë të dhënat e parashtruara në padi ku përveç datës së lidhjes së martesës nuk ka asgjë të vërtet. Kështu nuk qëndron fare fakti kryesor se kjo lidhje e martesës nuk ka asgjë të vërtet. Kështu nuk qëndron fare fakti kryesor se kjo lidhje e martesës ka pasur vetëm aspekt formal, ndërsa aspekti faktik nuk ka ekzistuar sepse me prova vërtetohet ndryshe nga ajo që është cekur. Pra gjatë muajt Shkurt te vitit 2015 jemi takuar në kërkesën e tani paditësit dhe në prezencën e 6 personave pas bisedimeve jemi dakorduar për fejesë. Pas një muaji pikërisht me datën 03.03.2015 sipas zakoneve vendore misitet (shkuesit) në familje kanë kërkuar dhe është bërë FEJESA. Pas fejesës me datën 04.03.2015, paditësi me njërin nga misitet kanë ardhur në shtëpinë tonë dhe kanë kërkuar të

shkoi në Zyrën e Ofiqarisë së Gjendjes Civile në Rr. K-Gjakovë që të lidhim martesën tonë zyrtarisht. Pas këtij kurorëzimi jemi takuar disa herë tani me burrin dhe vlen të përmendet se një ditë pas kurorëzimit me datën 05.03.2015, paditësi ka organizuar një aheng (Dasmës) ku kanë marrë pjesë familjarët e të dy familjeve diku mbi 50 veta. Me datën 14.08.2015 me propozimin e paditësit atëherë bashkëshortet dhe duke i besuar "sinqeritetit" të tij se vërtet tani ne jemi bashkëshort dhe se sipas tij se shpejti do rregullohen letrat për Gjermani kemi udhëtuar për pushime në Turqi në Antalia ku kemi qëndruar 10 ditë në pushime-kinse muaj mjalti. Po ashtu gjatë Janarit të vitit 2016 kur ishte në pushim çdo ditë kemi qenë së bashku dhe më në fund thash se do të i përmbush premtimet sepse në prill 2016-tës me regjistroi në kursin (intenziv) të gjuhës Gjermane ku edhe kamë filluar vijimin. Mirëpo në ditën e tretë M. L. ka ardhur dhe me ka thënë që të mos vazhdoj kot kursin sepse Sh. ka thanë se do të ndahet nga unë pa kurrfarë arsyeje. Me këtë rast me këto vendime të pa përgjegjshme i njëjti me ka fyer personalisht, me ka shfrytëzuar dhe marrë vajzërinë (virgjinitetin) me çka me ka humbur shanset për martesë dinjitoze, me ka shkaktuar dhimbje shpirtërore, vuajtje dhe nervozë të pa masë duke me mashtruar mu dhe familjen duke prekur etiken Familjare, me çka vërtet na ka shkaktuar dëm të pa kompensuar jo material. Më vonë kuptuam se ky është i tillë dhe nuk është rasti i tij i parë por i treti e më tepër që vjen nga Gjermania dhe bënë këso marifete të pa zakonshme për trevën tonë. Nga sa u theksua dhe ajo që qëndron e shkruar shihet se kemi të bëjmë edhe me thirrje të gabuar në dispozitat ligjore sepse neni 67 i Ligjit për Familjen i Kosovës nuk përcakton e as trajton zgjidhjen e Martesës për ANULIMIN e saj dhe shkaqet për këtë. Në këtë rast Shkurorëzimi apo zgjidhja e martesës rregullohet me dispozitat e nenit 69 par.1 dhe 2 të këtij Ligji ku decidivisht janë paraparë edhe Shkaqet e shkurore të martesës apo zgjidhjes së martesës. Në rastin e cekur nuk ekziston asnjë nga këto raste dhe se të paditurës në këtë rast përveç që ka humbur vajzërinë (virgjinitetin) zbehur ardhmërinë, ka humbur reputacionin personal dhe familjar besoni se ka pësuar edhe psikikisht nga se me të marrë lajmin e vërtet është ndier keq për veten dhe familjen.

I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë kërkesë padisë, ndërsa sa i përket përgjigjes në padi, pretendimet e theksuara në përmbajtjen e të njëjtës konsideroj se në rastin konkret duhet trajtohen si jo lëndore. Sa i përket kërkesës të theksuar si në pikën 1 dhe 2 të dispozitivit të Aktgjykimit nga ana e palës së paditur. Në rastin konkret çështja lidhur me zgjidhjen e martesës është e rregulluar konform dispozitave të ligjit për familje, andaj të theksuarat në përgjigje në padi nuk duhet trajtuar e si të tilla të administrohen provat. Kjo çështje pas zgjidhjes së martesës siç parashihet konform dispozitës së nenit 69 pika 1 dhe 2 e që në këtë rast siç e rezervoj të drejtën gjer në fjalën përfundimtare po ashtu e njoftoj gjykatën se në rastin e përpilimit të padisë në dispozitiv është përvjedhur si gabim teknik dispozita e nenit 67, por kjo çështje konsideroj se ka është e mundur të rregullohet siç ceka më lartë gjer në fjalën përfundimtare. Konsideroj se çështja e shkëputjes të raporteve në mes të fejuarve në aspektin faktik, ndërsa çështja në aspektin formal është shkëput më tepër se gjashtë muaj, për afërsisht një viti dhe nga përgjigja në padi vetëm se e vërteton faktin se kjo çështje përkitazi për të qenë në lidhje martesore edhe në aspektin formal konsideroj se është tani e tutje e pa pranuar, ndërsa rreth pretendimit në përgjigjen në padi po qese pala i shpreson në kontestin civil kjo çështje është e rregulluar me ligj dhe ka afat të paraparë në ushtrimin e padisë por për një gjë të tillë e mbaj të drejtën që sipas nevojës një fakt i tillë ka të drejtë edhe pala paditëse, por duke pasur parasysh se në këtë çështje gjykata për kërkesa të tilla dhe të ngjashme nuk do të lëshohet dhe nuk ka nevojë të administrimit të asnjë prove të kësaj natyre. Andaj i propozoj gjykatës që të veprohet sipas kërkesë padisë për zgjidhje të martesës.

I autorizuari i të paditurës gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në tërësi mbetem pranë përgjigjes në padi të cilën e kemi ushtruar me dt. 07.06.2016, dhe nuk pajtohem me konstatimet e të autorizuarit të paditëse dhe me këtë përgjigje ka pretendime, por këtu ka fakte të vërtetuara dhe

që edhe më tej mund të vërtetohen me procedim të dëshmitarëve të cilët do ti propozojmë, ndërsa padia në tërësi është jo e bazuar dhe e mbështetur në thënie të pa vërteta të cilat sigurisht paditësi ia ka referuar të autorizuarit të tij i cili nuk mund të thirret si përgjegjës për këto sepse duke filluar nga pasusi i parë i padisë ku thuhet se kemi të bëjmë me një martesë apo akt vetëm formal të martesës i njëjti nuk qëndron ngase paditësi dhe e paditura përveç aktit të lidhur formal tek organi kompetent në Zyrën e ofiqarisë të gjendjes civile kanë kaluar së bashku një pjesë të mos themi të jetës më të bukur të tyre (mendoj për të paditurën) ngase paditësi është apo më vonë kemi kuptuar se i tillë ishte, ta quajmë me fjalorin penal recidivist duke ardhur nga bota e jashtë, duke qitur në lajthitje vajzat tona duke u treguar si i pasur dhe të njëjtat duke i marr, dërguar në pushim kohë pas kohe duke i vizituar dhe më në fund në mënyrë të një anshme pa asnjë marrëveshje, as njoftim paraprak angazhon avokat të cilët po ashtu i qet në lajthitje dhe pa u përmbushur asnjë kusht nga neni 69 pika 1 dhe 2 i Ligjit për Familje të Kosovës ia kërkon zgjidhje të martesave. Pikërisht paditësja që gjendet këtu është vajza e tretë që ka pësuar këtë fat nga paditësi. Nuk qëndron fakti se këta nuk kanë pasur kontakte as më shumë se një vit e as më shumë se gjashtë muaj, sepse i njëjti sa herë ka ardhur në pushim në shtatorin e vitit të kaluar, për vitin e ri të vitit 2016 dhe diku në prill kur e ka regjistruar në kursin inteziv të gjuhës gjermane duke i thënë se posa ta kaloj këtë test do të marr që të jetosh në gjermani dhe duke marr në fakt bashkëshorten e tij dhe duke i kaluar disa ditë sipas qejfit të tij, ndërsa tani ushtron padi për zgjidhje të martesës pa e vëra fare ndërgjegjja për moralin personal këtu të paditurës, moralin familjar, familjen e të cilës e ka implikuar në këtë çështje si nga dërgimi i shkuesve apo misitëve, shkuarjes dhe marrjes për kurorëzim, organizimit të gazmendit të dy familjarëve për martesën, shkuarjes në pushim në Antaly me bashkëshorten 10 ditë, dhe duke shkuar sa herë ka ardhur në shtëpinë e prindërve të saj, duke marr bashkëshorten e tij dhe ekspozuar në restorante dhe hotele anë e mban Kosovës. Mendoj se me këto veprime i njëjti bashkëshortes së tij ia ka cenuar integritetin personal, moral, familjar, e ajo që është më kryesorja i ka marrur vajzërinë (virgjinitetin) dhe fare nuk e vret ndërgjegjja për këtë. Ne si profesionistë tani e dimë se ligji mbi familjen kurorëzimi nuk mbahet me dhunë, mirëpo pretendimet tona janë që pasi paditësi kur të dëshiroj të vij në Kosovë të ftohet të ballafaqohet me të paditurën dhe i njëjti të dëgjoj rrëfimin e saj për brengat, shqetësimet dhe nervozen të cilën ia ka shkaktuar me aktin e një anshëm pa kurrfarë bisede por duke i dërguar fjalë për njërin nga shkuesit dhe atë M. L. i cili këtu të paditurës në kursin intenziv të gjuhës gjermani ka shkuar dhe i ka thënë “mos e vazhdoni kotë këtë kurs ngase Sh. ka biseduar me një avokat që të zgjidhë martesën dhe të shkurorëzohet me ty”. Të gjitha këto i prezantuar me prova të bashkangjitura në përgjigje në padi duke filluar nga ahengu familjar, pushimi në Antaly, si dhe provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Shtoj se në cilësinë e dëshmitarit të ftohet M. L. nga Gjakova dhe M. B. nga fshati R., Komuna e Pejës.

I autorizuari i paditësit lidhur me replikën e të autorizuarit deklaroi se konsideroj se i autorizuari i të paditurës ri thekson të dhënat nga përgjigja në padi dhe konsideroj se asnjë provë nuk është e bashkangjitur edhe për kundër faktit se thekson se në cilësi të profesionalistëve çështja lidhur me zgjidhjen e martesës nuk mund të ndalohet kur raportet në mes të bashkëshortëve kanë pushuar për çështje të bindjeve kontradiktore të tyre, e në bazë të ligjit në fuqi nuk kërkohet fajësia nga ana e palëve, i konsideroj irelevante të gjitha çështjet e theksuara në këtë çështje për faktin se siç parashihet në bazë të ligjit dhe të theksuara më lartë administrimi i këtyre provave mund të kërkohet pas ushtrimit të padisë dhe shpresimit të saj e që gjykata lidhur me të njëjtat merr vendim në mënyrë meritore. E kundërshtoj në tërësi propozimin lidhur me dëshmitarin e propozuar e po ashtu edhe të dëshmitarit tjetër M. B. për faktin se gjykata do të vendos në kuadër të kërkesë padisë e që bëhet fjalë vetëm për zgjidhjen e martesës dhe pa asnjë trajtim të ndonjë kërkesë tjetër të paraparë nga LFK-së.

I autorizuari i të paditurës lidhur me replikën e të autorizuarit deklaroi se e kundërshtoj propozimet e të autorizuarit të paditësit se gjykata duhet vetëm të zgjidhë martesën në këtë rast

pasi që siç është cekur edhe në përgjigjen në padi, për tu zgjidhur martesë duhet të jetë i plotësuar së paku një nga kushtet e parapara në nenin 69 parag. 1 dhe 2 të LFK që në këtë rast nuk kemi asnjë nga këto kushte por vetëm dëshirën e paditësit që “të luaj me moralin e vajzave tona”, andaj, ne përveç që insistojmë në ballafaqimin e paditësit me të paditurën për të parë me çfarë personi kemi të bëjmë fatbardhësisht nuk i ka ndodhur ky rast asnjërit nga familjaret tonë si psh. vajzës sime apo të autorizuarit të paditësit, sepse ndryshe do të reagojmë ngase e dimë se morali dhe cenimi i tij tek ne shqiptaret ka qenë pika më e ndejshme, andaj nëse dikush ka arritur të bëjë para nuk është mirë të vë në lajthitje vajzat tona dhe ti shëtit pak nëpër botë dhe pastaj ti kthej tek dera e shtëpisë dhe ti hudhë si leckë. Ne sigurisht nuk jemi ata që vendosim, gjykata do të vendos lidhur me këtë, por një akteri të tillë deri në fund të fundit do të shfrytëzojmë mundësit tona ligjore që të mos ta lëmë të lirë të veprojnë me vajzat tjera në këtë mënyrë siç i ka ndodhur këtu të paditurës dhe dy paraardhësve të saja. Nëse na refuzohen kërkesat aksesore që kemi kërkuar me përgjigje në padi jemi të njoftuar për procedurën dhe të njëjtën sigurisht do ta vazhdojmë.

I autorizuari i paditësit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se konsideroi se me administrimin e provave në përgjithësi është vërtetuar se çështja në marrëdhëniet në mes paditësit dhe të paditurës është shkëputur për shkak se botëkuptimet e tyre dhe arsyet që palët i kanë në dijeni dhe paditësi ka krijuar shpenzime me një shumë të konsideruar, por duke pas parasysh çështjen se me këtë rast kërkohet vetëm zgjidhja e martesës, nuk kemi theksuar nxjerrje të provave të kësaj natyre.

Shpenzimet procedurale i kërkoj sipas TA-së.

I autorizuari i të paditurës në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se duke filluar nga çështja e shkruar dhe në mënyrë decidive e cekur në padi, konsideroi se që nga fillimi e njëjta është hartuar mbi keq informimin e të autorizuarit të tij nga ana e paditësit, ashtu që ajo fillon me të pa vërteta se konsiderohet se ka ekzistuar vetëm një akt formal i lidhjes së martesës, ndërsa këta as një moment nuk kanë bashkëjetuar dhe nuk i kanë gëzuar të mirat e martesës. Me nxjerrjen e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe me procedimin e dëshmitarit këtu tani prezencë, i cili tanë rrjedhës së ngjarjes ka qenë prezentë deri në ditën e martesës dhe tani kur tentohet zgjidhja e saj u vërtetua se paditësi e ka njohur të paditurën dy tre muaj para martesës, i është dhënë mundësia të bisedoi me të dhe familjen e saj, pasi që mendoi se me rastin e martesës është me rëndësi edhe familja prej nga rrjedhë bashkëshortja apo bashkëshorti, u vërtetua po ashtu sipas traditës e ka kërkuara me misitë dorën e saj, pas dhënies se pranojmë që vajza e tyre të martohet me të, i njëjti ka bërë kurorëzimin e kësaj martese në mënyrën e duhur, ka organizuar ahengun e martesës, i cili tani zakonisht në të gjitha t=dasmat organizohet nëpër lokale, ku marrin pjesë të ftuarit, sikurse këtu 50-60 veta, ka marrë tani më bashkëshorten e tij sa herë ka dëshiruar për të kaluar kohë me të nëpër hotele dhe restorante (si duket ai as që ka shtëpi këtu) por vie nga përdërimi me automjete të ndryshme dhe kështu keqpërdor vajzat dhe motrat tona shqiptare, nga se kjo ishte martesë e tretë apo e katërt e tij, në mënyrë të njëjtë me skenar dhe elegjtitë e tij. Nga padia e përpiluar po të lexohet me vëmendje shihet se në të njëjtën nuk ka as të përmendur kalimthi asnjë nga shkaqet e nenit 69 të Ligjit për Familjet të Kosovës, ku në parag. 2 taksativisht janë të numëruara shkaqet si vijon: jeta e padurueshme bashkëshortore, shkelja e besnikërisë, vepra penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtim serioz, lënia qëllim keqe dhe e pa arsyeshme, sëmurje psikikë e pa shëruar, pa aftësi e vazhdueshme për të vepruar, e as më në fund nuk ekziston as ndërprerja e pa arsyeshme e jetës faktike të përbashkët, sepse i njëjti sa herë ka ardhë ka bota e jashtme ka marrë bashkëshorten e tij dhe ka vizituar hotelet dhe restorante nëpër Kosovë, dhe tani në fund kur të njëjtën me qëllim e largon ngas puna duke i thënë se unë të financoi ia ndërpre në kursin e gjuhës gjermane në Pejë, për të ardhur në Gjakovë, ndërsa tri katër ditë më vonë përmes ndërmjetësit i deklaroi se mos të kryej pa lidhje at kurs, nga se ai muaj më parë kishte ushtruar padinë. Këtu

shihet se kur asnjë nga shkaqet e shkarëzimit nuk ekziston, shihet, moral, sjellja dhe pafytyrësia e paditësit që është mësuar të bëjë skenarë të tilla sepse ma në fund “po i pinë ujë”. Ne Gjykatës i propozojmë që padinë pasi nuk ka me vete asnjë nga shkaqet e lartcekura, nga se edhe e tillë është dhe paditësin ta detyroi në pagesën e shpenzimeve procedurale dhe atë për përgjigje në padi dhe sa e diju ne kemi mbaj dy seanca e jo tri, shpenzimet për dy seanca. Ndërsa në kuptimin e refuzimit të dy propozimeve të cilat i konsideroi esenciale për vendosjen e kësaj çështje, Gjykatën e njoftoi se në ankesën kundër Aktgjykimit do të përfshihen edhe ato.

Shpenzimet procedurale i kërkoi sipas TA-së.

Gjykata në procedurën e provave ka bërë shikimin dhe leximin e Certifikatës së martesës me nr. ser. M10140601 me nr. ref. 2/2015 RM/2012 me nr. rend. 6, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë, me dt. 13.04.2016, Raportit nga Qendra për Punë Sociale në Gjakovë, me nr. 692/16 të dt. 19.05.2016, i pasaportës së të paditurës me fotokopje me ngjyra ku vërtetohet se e njëjta ka qenë në Turqi prej dt. 14.08.2015 gjer me dt. 24.08.2015, i dy fotove në rastin e nënshkrimit të kurorës pranë Zyrës së Ofiqarisë, dy fotove në ahengun e organizuar pas lidhjes së kurorës dhe katër fotot me rastin e shkuarjes në pushim në Turqi, procedimi i dëshmitarit M. B. nga fshati R, Komuna e Pejës, dhe pas vlerësimit të fakteve juridike – relevante të kësaj çështje, çmuarjes me ndërgjegje e të kujdesshme të provave të administruara, në kuptim të nenit 8 të LPK, e miratoj kërkesë-padinë për zgjidhjen e martesës bazuar edhe në nenin 69 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Familjen të Kosovës (Ligji nr.2004/32 i publikuar në “Gazetën Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë” nr.4, të dt.01.09.2004, në tekstin e mëtejme LFK).

Nga provat e administruara u argumentua kjo gjendje faktike:

Nga Certifikata e martesës me nr. ser. M10140601 me nr. ref. 2/2015 RM/2012 me nr. rend. 6, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë, me dt. 13.04.2016, rezulton se palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë me datën 04.03.2015, në zyrën e gjendjes Civile në fshatin R., Komuna e Gjakovës dhe nga kjo martesë bashkëshortët nuk kanë fëmijë.

Nga Raporti i Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë, me nr. 692/16 të dt. 19.05.2016, Gjykata është njoftuar se procedura e pajtimit përmes së cilës do të tentohej të arrihet rivendosja e bashkësisë martesore mes bashkëshortëve H. nuk mund të zbatohet duke qene se bashkëshorti Sh. H. është me vendbanim në Gjermani, ndërsa bashkëshortja B. H., e lindur B., është me vendbanim në fshatin R., Komuna e Pejës. Sipas padisë së Sh. H., martesë e tyre duhet të zgjidhet me shkurorëzim me që nuk iu është realizuar bashkimi familjar me B.. Edhe pse të kurorëzuar bashkëshortët H. nuk kanë jetuar asnjë ditë bashkë prandaj në këtë martesë nuk kanë lindur fëmijë.

Nga shikimi i pasaportës e të paditurës, pasaportë e fotokopjuar me ngjyra ku përmes vulave të doganës së shtetit të Turqisë vërtetohet se e njëjta ka qenë në Turqi prej dt. 14.08.2015 gjer me dt. 24.08.2015.

Nga dy fotot në rastin e nënshkrimit të kurorës pranë Zyrës së Ofiqarisë shihen bashkëshortit gjatë nënshkrimit të kurorës në Zyrën e Ofiqarisë dhe nga dy fotove në ahengun e organizuar pas lidhjes së kurorës shihet familjaret te ftuar me rastin e ceremonisë dhe katër fotot me rastin e shkuarjes në pushim në Turqi shihen bashkëshortit duke kaluar pushimet në Turqi.

Nga procedimi i dëshmitarit M. B. nga fshati R., Komuna e Pejës, I njëjti në pyetjet e të autorizuarit të paditurës: se a është i njoftuar me rrjedhën e procedurës që nga fejesa e këtu të paditurës B. dhe deri në momentin kur kemi dëgjuar se është ushtruar padia për zgjidhjen e

martesës? Dëshmitari ka deklaruar se diku në muajin mars ka ardh M. me dajën e vet, S. N. me sa më kujtohet dhe e kanë kërkuar B. për paditësin - Sh. H. dhe ne sipas traditave kemi besuar M. dhe dajës së tij i cili ka qenë në moshë, aty në odë kanë qenë diku rreth 10-12 persona ku më i riu ka qenë 30 vjet dhe më i vjetri 89 vjet gjegjësisht prindi Gj., kemi ndejt ju kemi qit kafe dhe ja kemi bërë përhejërë, pas dy dite pasi ja kemi bërë përhajrë kanë lidhur kurorë, pastaj ka shkuar në Gjermani prapë ka ardhë dhe me B. janë dal në restorante si dhe kanë shkuar në pushime në Turqi-Antali (10 ditë), shton se B. ka ndjek kursin e gjuhës gjermane në Pejë, pastaj ka propozua në Gjakovë, ku ka vijua kursin tri ditë dhe pastaj nga M. është njoftuar se kinse Sh. i ka thënë se thuaj B. se nuk ka nevojë ta ndjekë kursin e gjuhës gjermane se me nuk kemi kurrigjë në mes veti. I autorizuari i të paditurës pyet dëshmitarin: se pas kurorëzimit M. a ka pas farë ahengu – dasëm? Dëshmitari u përgjigje: se po ka pasur një aheng ku kanë qenë 50-60 mysafirë te Ujëvara e Drini në fsh. R., K. Pejës, ku kemi qenë familjaret e mi dhe të B. ka qenë familja e gjer B., Sh. M. S., dy motrat e M.. I autorizuari i të paditurës pyet dëshmitarin: se a ka qenë B. e punësuar dhe pse e ka ndërprerë punësimin? Dëshmitari u përgjigje: po ka qenë e punësuar në një shitore me teknik të bardhë mirëpo sigurisht Sh. i ka thënë se nuk ke nevojë më të punosh, shton se Sh. e ka ndihmuar materialisht. I autorizuari i të paditurës pyet dëshmitarin: se a mund të kthehet e paditura në at vend të punës? Dëshmitari përgjigjet: besoi se jo pasi që ai vend i punës është plotësuar. I autorizuari i të paditurës pyet dëshmitarin: se ju deklaruat se në Odë kanë qenë rreth 10-12, a ka qenë takimi i parë i paditësit? Dëshmitari u përgjigje: se jo nuk ka qenë takimi i parë pasi që me B. kanë qenë në bisedime para tre muajve më herët, pasi që kanë ndejtur bashkë me djalin e axhës, gruan etj. I autorizuari i paditësit pyet: a ka pas ndonjë rast para tjetër për me ja lyp dorën? Dëshmitari u përgjigje: po ka pas. I autorizuari i paditësit pyet: a të kujtohet data e ahengut të organizuar? Dëshmitari u përgjigje: se përafërsisht 10-15 ditë pas lidhjes së kurorës. I autorizuari i paditësit pyet: shpenzimet e kujt kanë qenë ato? Dëshmitari u përgjigje: se shpenzimet i ka mbuluar Sh. sepse kemi qenë mysafirë të tij. I autorizuari i paditësit pyet dëshmitarin: se a ka qenë me vendim e punësuar e paditura dhe sa i ka pasur pagën? Dëshmitari u përgjigje: se e di se a ka qenë e punësuar por nuk di a ka qenë me vendim dhe nuk e di sa e ka pas pagën. I autorizuari i paditësit pyet dëshmitarin se përpos këtij ahengu a ka pasur dasmë sipas traditës dhe përcjellje të nuses dhe a ka qenë e paditura ndonjëherë si nuse e shkuar në shtëpinë e paditësit? Dëshmitari u përgjigje: se nuk ka pas përcjellje as dasmë, e njëjta nuk ka shkuar në shtëpinë e paditësit si nuse. Mirëpo kanë dal sa herë që kanë dashtë dhe kanë qenë në pushime 10 ditë në Antalia – Turqi. Kryetari i Trupit gjykues pyet dëshmitarin se a kanë pas bashkëshortët ndonjë konflikt ndërmjet veti? Dëshmitari u përgjigje: nuk di, mirëpo sipas deklarimit të paditurës e njëjta ka thënë se paditësi i ka thënë të mos vijoj kursin.

Gjykata në rastin konkret konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 69 pika 1, 2 dhe 4 të LFK, sepse martesë e ka humbur qëllimin dhe efektin e vet për të cilin është lidhë. Është fakt se martesë lidhet në bazë të dashurisë, simpatisë, besnikërisë dhe vullnetit reciprok të bashkëshortëve. Mirëpo, meqë në rastin konkret këto elemente qenësore mungojnë, Gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit të para cituar, ku janë paraparë shkaqet e shkurorëzimit si shkaqe të përgjithshme dhe shkaqe të veçanta. Shkaqet e përgjithshme të shkurorëzimit të përcaktuara me nenin 69 par.1 dhe 2 të LFK, parasheh se bashkëshortet mund të e kërkojnë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme. Si shkaqe që sjellin çrregullimin serioz të marrëdhënieve bashkëshortore mund të jenë; xhelozia, mos përputhja e karaktereve dhe grindja e vazhdueshme. Ndërsa shkaqet e veçanta janë të parapara në nenin 69 par.1 dhe 2 të LFK, ku përcaktohen si; jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, vepra penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, ndërprerja e pa arsyeshme e jetës faktike, sëmundja psikike e pa shërueshme etj. Pra, në rastin konkret kjo bashkësi martesore faktikisht ka pushuar së ekzistuari.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr konform nenit 450 të LPK-së.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.179/16 dt. 17.08.2016

Bashkëpunëtori profesional:
Nëntor Oseku

Kryetari i Trupi Gjykes,
Gjykatësi
Drilon HARAÇIA

UDHËZIM JURIDIK; Kundër këtij Aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve pas marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.